



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria-Vlada-Government*



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

# **RAPORTI I GJENDJES PERINATALE NË KOSOVË PËR VITIN 2018**

*Departamenti i Mjekësisë Sociale  
Observatori për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe të Rinjve – IKSHPK*



**RAPORTI I GJENDJES  
PERINATALE NË KOSOVË PËR  
VITIN 2018**

*Observatori për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe të Rinjve – IKSHPK  
Prishtinë 2019*

**Botuesi:**

**Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës**

Copyright:

**Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës**

Përdorimi i të dhënave lejohet vetëm kur citohet burimi i të dhënave.

## **Parathënie**

Publikimi “Raporti i gjendjes perinatale në Kosovë për vitin 2018” përfshinë të dhënat në dispozicion të raportuara nga institucionet shëndetësore dhe Agjensioni i Statistikave të Kosovës (ASK).

Në këtë publikim përfshihen të dhënat mbi definicionet, lindjet dhe vdekshmërinë e foshnjeve të ndarë sipas periudhave të ndryshme të jetës së foshnjeve. Të dhënat kryesore perinatale dhe lindjet janë të prezantuara sipas viteve 2000-2018. Lindjet janë të raportuara sipas niveleve të kujdesit shëndetësor nga institucionet shëndetësore publike dhe private.

Të porsalindurit janë të prezantuar sipas grup-peshës dhe mënyrës së lindjes.

Foshnjat e vdekura janë të prezantuara sipas moshës, gjinisë, moshës së nënës, rradhës së lindjes, statusit martesor dhe nivelit të edukimit të nënës.

Koeficientët e vdekshmërisë perinatale dhe infantile janë të prezantuara sipas komunave.

Falenderojmë të gjitha institucionet shëndetësore të Kosovës të cilat ofruan bashkëpunim në mbledhjen e të dhënave. Besojmë se ky publikim do të shërbejë si informacion shumë i dobishëm për t’u njohur më mirë me gjendjen perinatale në Kosovë.

Ftojme të gjithë shfrytëzuesit e këtij hulumtimi për bashkëpunim duke dhënë vërejtje, komente dhe propozime me qëllim të ngritjes së cilësisë në këtë lëmi tejet të domodoshme për zhvillimin, planifikimin, organizimin dhe menaxhimin e sistemit shëndetësor në Kosovë në dobi të ruajtjes dhe përparimit të shëndetit të nënës dhe fëmijës.

Prof. Dr. Naser Ramadani, MD., PhD. C.M.I.S., C.I.E.H.

Drejtor ekzekutiv i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës

## **PËRMBAJTJA**

PËRMBAJTJA.....	6
PËRMBLEDHJE .....	7
DEFINICIONET .....	8
METODOLOGJIA .....	10
TË DHËNAT KRYESORE .....	11
LINDJET.....	12
VDEKSHMËRIA E FOSHNJEVER.....	18
VDEKSHMËRIA FETALE.....	20
VDEKSHMËRIA PERINATALE .....	21
PËRFUNDIMET .....	26
REKOMANDIMET .....	28
BIBLIOGRAFIA .....	29
ANEX .....	30

## **PËRMBLEDHJE**

Në vitin 2018, sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, janë raportuar gjithsej 22,870 lindje, 6,210 janë lindje jashtë Kosovës. Nga gjithsej lindje në Kosovë, kemi 22,761 të lindur gjallë dhe 109 të lindur vdekur.

Nga institucionet shëndetësore janë kryer me prerje cezariane 18.2% të lindjeve.

Sipas të dhënave të ASK, shkalla e vdekshmërisë fetale është 4.8‰, vdekshmëria neonatale e hershme 6.5‰, vdekshmëria perinatale 11.2‰ dhe vdekshmëria infantile është 10.6‰.

Përkundër përmirësimeve në shëndetin perinatal situata nuk është e kënaqshme. Problemi i raportimit vazhdon të mbetet, dhe kjo shkon krahas edhe me mungesën e raportimit të vdekjeve maternale si gjendje e ndërlidhur me shëndetin perinatal që së bashku reflektojnë edhe cilësinë e kujdesit shëndetësor.

Rëndësia e shëndetit perinatal qëndron në reflektimin e gjendjes shëndetësore të vendit dhe cilësinë e sistemit shëndetësor prandaj është e paraparë edhe në objektivën e Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë.

Ky raport i dedikohet vendimmarrësve, institucioneve shëndetësore dhe profesionistëve shëndetësorë me qëllim identifikimit të situatës dhe monitorimit në vazhdimësi si dhe planifikimit të masave specifike adekuate në adresimin e problemeve rreth shëndetit perinatal.

## DEFINICIONET

Indikatori Perinatal është indikator kyç dhe senzitiv i gjendjes shëndetësore dhe reflekton kujdesin prenatal, gjatë lindjes dhe kujdesin për të porsalindurit.

Poashtu reflekton si indikator i tërthortë për gjendjen shëndetësore të nënës, organizimin dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor.

Definicionet e indikatorëve janë shfrytëzuar nga korniza e treguesve të shëndetit të fëmijës dhe nënës e cila është produkt i grupit punues në nivel nacional dhe i përkrahur nga Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit në Republikën e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, IKSHPK dhe UNICEF-i.

**I lindur** nënkupton shkëputjen e tërësishme e fetusit të vdekur që peshon më shumë së 500 g apo të fetusit të gjallë nga trupi nënës pavarësisht nga kohëzgjatja e shtatzanësisë.

**I lindur gjallë** nënkupton shkëputjen e tërësishme nga trupi i nënës të produktit të konceptcionit, pavarësisht nga kohëzgjatja e shtatzanësisë, i cili produkt pas ndarjes, merr frymë apo tregon shenja të jetës si p.sh të rrahurat e zemrës, pulsimit të kordonit të kërthizës apo lëvizje vullnetare të muskujve, pavarësisht nëse kordoni i kërthizës është prerë apo placenta është ngjitur.

**I lindur vdekur:** Vdekja para daljes apo nxerrjes prej nënës së vet e produktit të konceptcionit pa marrë parasysh kohëzgjatjen e shtatzanësisë; vdekja është përcaktuar sipas faktit se pas ndarjes së tillë fetusit nuk merr frymë apo nuk tregon ndonjë shenjë tjetër jete, siç janë rrahjet e zemrës, pulsimet e kordonit umbilikal apo lëvizjet e përcaktuara të muskujve të vullnetshëm (ASK)

### **Shkalla e të lindurve të vdekur (Vdekshmëria fetale)**

Numri i të lindurve të vdekur për 1,000 të lindur (të lindur gjallë dhe të lindur të vdekur). Vdekja e frytit mund të ndodhë para lindjes – gjatë shtatzanësisë dhe gjatë lindjes.

Për qëllime të krahasimeve kombëtare, lindjet e vdekura janë të definuara si tremujor i tretë i vdekjeve fetale ( $\geq 500$  g ose  $\geq 22$  javë).

Për qëllime të krahasimeve ndërkombëtare, lindjet e vdekura janë të definuara si tremujor i tretë i vdekjeve fetale ( $\geq 1,000$  g ose  $\geq 28$  javë).

### **Shkalla e vdekshmërisë perinatale**

Numri i vdekjeve perinatale (të lindur të vdekur dhe vdekje të hershme neonatale) e shprehur për 1,000 të lindur.

**Shkalla e vdekshmërisë neonatale (mortaliteti neonatal)** definohet si numri i fëmijeve të lindur të gjallë që vdesin pa i mbushë 28 ditë të jetës (0-27 ditë) e shprehur për 1,000 të lindur gjallë brenda një viti kalendarik.

**Vdekjet neonatale** (vdekjet gjatë 28 ditëve të para të jetës së foshnjës) mund të ndahen në:

**vdekjet e hershme neonatale**, që ndodhin brenda 7 ditëve (0-6 ditë) të para të jetës dhe

**vdekjet e vonshme neonatale** që ndodhin pas ditës së 7, (7-27 ditë), por para se të përfundohet dita e 28-të.

### **Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave (Mortaliteti infantil)**

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjeve paraqet numrin e foshnjeve të vdekura para moshës 1 vjeçare (0-11 muaj) të shprehur për 1,000 të lindur të gjallë, në një periudhë të caktuar kohore. Vdekshmëria e foshnjave paraqet probabilitetin që fëmija të vdesë para se t'i mbushë 1 vjet për 1,000 të lindur të gjallë.

**Shkalla e vdekshmërisë maternale** paraqet numrin e grave të vdekura nga ndonjë shkak që lidhet me (ose është shkaktuar nga) shtatzëninë (duke përfshirë shkaqe aksidentale apo të rastësishme) dhe vdekjet gjatë lindjes ose brenda 42 ditëve pas përfundimit të shtatzënisë, pavarësisht nga kohëzgjatja dhe vendi i shtatzënisë, e shprehur në 100,000 të lindur gjallë, për një periudhë të caktuar kohore.

**Vdekje e vonshme maternale** është vdekja e një gruaje nga shkaqe të drejtpërdrejta ose të tërthorta më shumë se 42 ditë, por më pak se një vit pas përfundimit të shtatzënisë.

## METODOLOGJIA

Për përpilimin e raportit janë përdorur të dhënat për vitin 2018 nga ASK-së për statistikat vitale si dhe të dhënat e raportuara nga institucionet shëndetësore dhe të përpiluara në raporte nga IKSHPK.

Regjistrimi dhe grumbullimi i të dhënave për statistikat vitale janë detajuar sipas institucioneve relevante dhe kompetente në çdo fazë të procesit.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave demografike në nivel nacional. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) gjegjësisht Departamenti i Sistemit të Informimit grumbullon të dhënat e raportuara nga institucionet shëndetësore dhe bënë raportimin e fenomeneve vitale përmes raporteve nga institucionet shëndetësore relevante, ndërsa Departamenti i Mjekësisë Sociale gjegjësisht njësia e Observatorit të Nënës, Fëmijës dhe Rinisë bënë analizën e indikatorit të disagreguar.

- ASK është përgjegjës për grumbullimin e të dhënave nëpër hapat si më poshtë: çdo institucion shëndetësor dhe zyrë e gjendjes civile ka plotësuar Fletëzat statistikore për vdekje DEM-2
- Në baza mujore, institucionet shëndetësore dhe zyrat e gjendjes civile kanë raportuar në zyrat regjionale të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), duke dorëzuar kopjet fizike të të gjitha DEM-2 të plotësuar.
- Zyrat regjionale të ASK, me pasqyrën mujore të të dhënave për lindje dhe vdekje DEM-5, kanë raportuar në ASK.
- Departamenti i statistikave sociale – sektori i statistikave vitale në ASK, ka kontrolluar cilësinë dhe ka konfirmuar të gjitha të dhënat.
- Të gjitha të dhënat janë futur në programin Access në Departamentin e IT-së.
- Sektori i statistikave vitale ka kontrolluar të dhënat në databazën e vdekjeve dhe ka përpunuar të dhënat me SPSS.
- ASK ka publikuar në faqen e internetit raportin “Statistikat e vdekjeve”
- Grumbullimin e të dhënave nga institucionet shëndetësore relevante dhe kalkulimin e indikatorit të disagreguar sipas gjinisë, komunave, moshës si dhe prezantimin e trendit e ka realizuar IKSHPK, Departamenti i Mjekësisë Sociale, Njësia e Observatorit të Nënës, Fëmijës dhe Rinisë.

## **Sfidat për grumbullimin e të dhënave:**

- Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) sfida është mungesa e pyetësorit të standardizuar nga tri institucionet Agjencia së Statistikave të Kosovës, Agjencia e Regjistrimit Civil dhe Ministria e Shëndetësisë, IKSHPK
- Përfshirja në raportim e të gjitha komunave të Kosovës.
- Mungesa e analizimit të Shkaqeve të vdekjeve për vitin 2017 në nivel nacional gjë që reflekton në orientimin e masave intervenuese.
- Mortaliteti perinatal si indikator ndikohet prej faktorëve të jashtëm, jashtë sistemit shëndetësor dhe jo vetëm prej kujdesit shëndetësor.

## **TË DHËNAT KRYESORE**

Shëndeti i grupeve vulnerable të popullatës të porsalindurit dhe nënat, janë indikatorë kryesorë të shëndetit dhe mirëqenies së popullatës. Sipas raportit Europian, çdo vit në Evropë ka më shumë se 40,000 familje që kanë humbur një fëmijë. Në vitin 2015 normat e lindjes së foshnjeve dhe vdekja neonatale, foshnjore dhe amtare ishin më të ulëta për foshnjat dhe gratë në Evropë sesa në pjesët e tjera të botës.

Sipas Raportit Europian Perinatal 2015, shkalla e vdekshmërisë fetale mesatare ishte 2.7 për 1000 lindje. Shkallët nën 2,3 për 1,000 lindje janë raportuar në Qipro, Islandë, Danimarkë, Finlandë dhe Hollandë, ndërsa mbi 3.5 për 1,000 lindje u raportuan në Sllovaki, Rumani, Hungari dhe Bullgari. Në Kosovë për vitin 2018, vdekshmëria fetale u raportua 4.8%. Për shkallën e vdekshmërisë neonatale mesatarja evropiane ishte 2.2 për 1,000 lindje të gjalla. Vendet me shkallë të vdekshmërisë neonatale 1.5 për 1,000 të lindur gjallë ose më të ulët ishin raportuar në Slloveni, Islandë, Finlandë, Norvegji, Republikën Çeke, Estoni dhe Suedi, ndërsa Irlanda e Veriut, Malta, Rumania dhe Bullgaria kishin norma mbi 3.5 për 1,000 foshnje të lindura gjallë. Krahasuar me vlerat e vendeve të Evropës Kosova ka vlerën më të lartë me 8.9%. Në Raportin Perinatal për vitin 2018 janë përfshirë vetëm disa prej indikatorëve bazikë mirëpo sfida tjetër për Kosovën do të jetë gjenerimi i indikatorëve të shëndetit perinatal sipas instrumentit Europian EURO-PERISTAT që mundëson pos monitorimit të standardizuar krahasimin me vendet tjera në Europë dhe dizajnimin e programeve për përparimin e shëndetit perinatal dhe shëndetit të popullatës.

Të dhënat perinatale kryesore për vitin 2018 të raportuara nga institucionet shëndetësore publike dhe private janë:

22,870 lindje, 6,210 jashtë Kosove

22,761 të porsalindur gjallë

109 të lindur vdekur

Raporti gjinor në lindje është 1,091 meshkuj në 1,000 femra

Shkalla e lindjeve me prerje Cezariane është 18.2 %

Gjithsej 242 foshnje të vdekura  
 109 ( 4.8‰), vdekje fetale  
 147 (6.5 ‰) vdekje të hershme neonatale (0-6 ditë)  
 256 (11.2‰) vdekje perinatale (vdekje fetale + hershme neonatale)  
 50 (2.2‰) vdekje të vonshme neonatale (7-27 ditë)  
 202 (8.9‰) vdekje neonatale (0-28 ditë).

Shkalla e vdekshmërisë perinatale për të posalindurit me peshë  $\geq 1,000$  gram që shfrytëzohet për krahasime ndërkombëtare është 11.2‰ (vdekshmëria fetale 4.8‰ dhe vdekshmëria e hershme neonatale 6.5 ‰).

**Tabela 1. Të dhënat kryesore perinatale për vitin 2018**

#	Modalitetet	2018
1	Numri i lindjeve	22,870
2	Numri i të posalindurve të lindur të gjallë	22,761
3	Numri i vdekjeve fetale	109
4	Shkalla e vdekshmërisë fetale (‰)	4.8
5	Numri i foshnjave të vdekura në javën e parë	147
6	Shkalla e mortalitetit të hershëm neonatal (‰)	6.5
7	Shkalla e vdekshmërisë perinatale (‰)	11.2
8	Shkalla e lindjeve me prerje cezariane (‰)	18.2

Burimi: ASK-Raportet: Lindjet, Vdekjet për 2018, \*IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2018

## LINDJET

Në vitin 2018, sipas të dhënave të ASK, janë raportuar gjithsej 22,870 lindje, 6,210 janë lindje jashtë Kosovës. Prej gjithsej 22,870 lindje, 22,761(99.5%) janë të lindur të gjallë, 109 të lindur të vdekur në Kosovë. Sipas IKSHPK-së janë raportuar gjithsej 23,162 lindje (lehona), me 23,462 të lindur gjallë dhe 137 të lindur vdekur. Numri i të lindurve gjallë më i lartë se numri i lehonave (lindjeve) spjegohet me faktin se fëmijët e lindur kanë qenë bineq apo treneq. (Tab.2) Diferenca e numrit të lindjeve nga ASK dhe IKSHPK për vitin 2018 tregon përafrim të të dhënave krahasuar me vitin paraprak (lindje 378 për 2017) ndërsa për 2018 për 292 lindje, për të lindurit gjallë kemi diferencën prej 757 per vitin 2017 ndërsa për vitin 2018 kemi diferencë mes ASK dhe IKSHPK-së, 701 të lindur gjallë, gjë që tregon përmirësim në raportimin e të dhënave mirëpo për vitin 2018 diferenca është më e madhe për vdekjet fetale, pra gjatë vitit 2017 kjo diferencë ishte vetëm 6 ndërsa per vitin 2018 kjo diferencë është 28 të lindur vdekur më shumë të raportuar në IKSHPK.

**Tab.2. Raportimi i të dhënave nga dy burimet e të dhënave**

#	Institucioni	Lindje (lehona)	Të lindur gjallë	Të lindur vdekur
1	IKSHPK	23,162	23,462	137
2	ASK	22,870	22,761	109
3	Diferenca	292	701	28

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2018  
ASK-Statistikat e Lindjeve, 2018

Bazuar në raportin e IKSHPK-së: “Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2018”, sipas nivelit të kujdesit shëndetësor, përqindja më e lartë e lindjeve është realizuar në spitalet e përgjithshme me 12,305 apo 53.1%, pason klinika obsterike gjinekologjike e QKUK-së me 9,963 lindje apo 43.0%, në maternitete 404 lindje apo vetëm 1.7%, ndërsa në spitalet private, spitali Bahceci, spitalin Amerikan, spitali Lindja dhe spitali Sirona 505 raste ose 2.2% (Tab.3).


**Tab.3. Lindjet sipas nivelit të kujdesit shëndetësor, institucionit, Kosovë-2018**

#	Institucioni	Gjithsej lindje (lehona)		Gjithsej foshnje të lindura		Prej tyre të lindura gjallë	
		N	%	N	%	N	%
1	QKUK	9,963	43.0	10,267	43.5	10,171	43.4
2	Spitali	12,305	53.1	12,421	52.6	12,382	52.8
3	Materniteti jashtëspitalor	405	1.7	405	1.7	404	1.7
4	Institucionet publike	22,673	97.9	23,093	97.9	22,957	97.8
5	Institucionet private	489	2.1	506	2.1	505	2.2
<b>Gjithsej</b>		<b>23,162</b>	<b>100.0</b>	<b>23,599</b>	<b>100.0</b>	<b>23,462</b>	<b>100.0</b>

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2018

Sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, gjatë vitit 2018 kemi pasur gjithsej 22,870 lindje, prej tyre 22,761 (99.5%) të lindur të gjallë, 109 të lindur të vdekur (Tab.1). Lindje të gjalla sipas gjinisë ishin femra 10,887 (47.8 %), kurse meshkuj 11,874 (52.2%) dhe koeficient të maskulinitetit në lindje 1,090.7‰.

Sipas raportit të lindjeve-2018 të ASK-së, sipas komunave më së shumti të lindur gjallë ka pasë në komunën e Prishtinës me 3,471 (11.9%) pason komuna e Prizrenit me 2,972 (10.2%) (Graf.1).




**Graf.1. Struktura e lindjeve sipas komunave, 2018**

Burimi: ASK-Statistikat e Lindjeve, 2018

## Trendi i lindjeve


Gjatë periudhës kohore 2000-2018 ka trend të rënies së numrit të lindjeve. Shihet se gjatë kësaj periudhe mesatarisht në vit kanë qenë 28,942 lindje me rënie mesatare prej 758 lindjeve në vit me determinim të saktësisë së vijës së trendit me 81.5%. (Graf.2).



**Graf.2. Trendi i lindjeve, Kosovë 2000-2018**

Burimi: Statistikat e Lindjeve, 2018


Numri mesatar i lindjeve në ditë në institucionet shëndetësore spitalore më i larti është në klinikën Gjinekologjike Obsterike të QKUK-së me 27.3 lindje, pason Prizreni me 9.3 lindje, Gjakova me 5.4 lindje dhe më së paku në Vushtrri me 1 lindje në ditë (Graf. 3).



**Graf.3. Numri mesatar i lindjeve në ditë në institucionet shëndetësore spitalore**

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2018

Gjatë vitit 2000, lindshmëria për 1,000 banorë apo nataliteti ishte 19.3%, ndërsa në vitin 2018 ishte 12.7%. Lindshmëria për periudhën 2000-2018 ka trend të rënies me lëvizje variabile (Graf.4).



**Graf.4. Trendi i natalitetit, Kosovë 2000-2018**

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2018

Sipas peshës së lindjes, 1,126 (4.9%) janë me peshë të ulët në lindje, ndërsa 21,091 (92.7%) me peshë mbi 2,500 g, ndërsa mbi 4,000 g, 2406 të lindur gjallë (10.6%). Pjesëmarrje më të madhe në lindje ka grup pesha 3000-3499g me 37.4% dhe 3500-3999g me 31.5%. (Tab.4)

**Tab.4. Të porsalindurit sipas peshës trupore**

#	Gjithsej lindje të gjalla	Pesha në lindje										X bar
		Më pak se 1,000	1000 – 1499	1500 – 1999	2000 – 2499	2500 – 2999	3000 – 3499	3500 – 3999	4000 – 4499	4500 e më shumë	E pa njohur	
N	22,761	46	119	205	756	3,007	8,509	7,169	2,087	319	544	3,395
%	100.0	0.2	0.5	0.9	3.3	13.2	37.4	31.5	9.2	1.4	2.4	

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2018

Sipas grup-moshës të nënës, 8,179 (35.9%) të lindur gjallë janë nga nënat e grup-moshës 25-29 vjet, pasojnë nënat e grup-moshës 30-34 vjet me 5,906 (25.9%). Moshja mesatare e nënave ka qenë moshja 29 vjeçe. (Tab.5)

**Tab.5. Të lindurit gjallë sipas grup-moshave të nënës, 2018**

#	Gjithsej lindje të gjalla	Grupmosha e nënës										Moshja mesatare
		14 e më pak	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50 e më shumë	E pa njohur	
N	22,761	3	697	4,460	8,179	5,906	2,831	605	65	13	2	29
%	100.0	0.0	3.1	19.6	35.9	25.9	12.4	2.7	0.3	0.1	0.0	

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2018

Sipas gjinisë së të porsalindurve 10,887(47.8%) janë të gjinisë femërore dhe 11,874 (52.2%) të gjinisë mashkullore.

Sipas vendit ku ka lindur fëmija, 22,837 (99.9%) kanë lindur me ndihmë profesionale (Tab. 6)

**Tab.6. Të lindur gjallë sipas gjinisë dhe vendit ku ka lindur fëmija, 2018**

#	Të lindur gjallë	Gjinia		Fëmija ka lindur në:	
		Femra	Meshkuj	maternitet / spital	Diku tjetër
N	22,761	10,887	11,874	22,837	33
%	100.0	47.8	52.2	99.9	0.1


Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2018

Nga institucionet shëndetësore raportohen 4,213 (18.2 %) lindje me prerje Cezariane, në institucionet publike nga gjithsej 22,673 lindje, 3,830 (16.9%) janë me prerje cezariane ndërsa në institucionet private nga gjithsej 489 lindje, 383 (78.3%) janë me prerje cezariane (Tab.7, Graf.5). Në klinikën Gjinekologjike Obstetrike të QKUK-së, 1,523 (15.3%) e lindjeve janë me prerje Cezariane. Sipas spitaleve, përqindja më e lartë e lindjeve me prerje cezariane është realizuar në spitalin e Pejës 699 (36.8%), pason spitali i Vushtrrisë me 145 (34.5%) dhe spitali i Gjakovës me 610 (31.1%) (Tab.7). Në spitale private kanë raportuar 383 (78.3%) lindje me prerje cezariane. Nëse krahasojmë me 3 vitet paraprake 2015, 2016 dhe 2017 ka rënie të lindjeve me prerje cezariane prej 27.3% në 24.3%, në 19.0% dhe në vitin 2018-18.2% .

**Tab.7. Lindjet me prerje Cezariane sipas institucioneve shëndetësore, Kosovë 2018**

#	Institucioni		Komuna	Lindje me prerje cezariane		Gjithsej lindje
				N	%	
1	Institucionet publike	QKUK	Prishtinë	1,523	15.3	9,963
		Spitali i përgjithshëm	Ferizaj	201	13.2	1,518
		Spitali i përgjithshëm	Gjakovë	610	31.1	1,963
		Spitali i përgjithshëm	Gjilan	436	25.5	1,713
		Spitali i përgjithshëm	Mitrovicë	192	13.6	1,409
		Spitali i përgjithshëm	Pejë	699	36.8	1,902
		Spitali i përgjithshëm	Prizren	24	0.7	3,380
		Spitali i përgjithshëm	Vushtrri	145	34.5	420
		Gjithsej			3830	17.2
	Maternitetet jashtëspitalore			0	0.0	405
<b>Gjithsej në Institucione publike</b>				<b>3830</b>	<b>16.9</b>	<b>22,673</b>
2	Institucionet private	Bahceci Healthcare	Prishtinë	140	85.9	163
		Spitali Amerikan Kosovë	Prishtinë	168	73.0	230
		Spitali Sirona	Prishtinë	75	78.1	96
	<b>Gjithsej në institucione private</b>			<b>383</b>	<b>78.3</b>	<b>489</b>
3	<b>Gjithsej</b>			<b>4,213</b>	<b>18.2</b>	<b>23,162</b>

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2018



**Graf. 5. Struktura e lindjeve sipas mënyrës së lindjes**

Burimi: IKSHPK – Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2018

## VDEKSHMËRIA E FOSHNJEVE


Gjatë vitit 2018, institucionet shëndetësore publike dhe private kanë raportuar gjithsej 242 foshnje të vdekura. Prej gjithsej 242 foshnjeve të vdekura, 147 (60.7%) janë vdekje neonatale të hershme, (foshnje të vdekura 0-6 ditë), vdekjet neonatale (0 deri 28 ditë) përbëjnë 197 (81.4%), vdekje neonatale të vonshme janë 50 (20.7%) dhe 45 (18.6%) janë vdekje postneonatale (Tab.8, Graf 6) ndërsa shkalla e vdekshmërisë sipas moshës është mortaliteti neonatal i hershëm 6.5%, mortaliteti neonatal i vonshëm 2.2% dhe mortaliteti postneonatal 1.8% (Graf. 7).

Mortaliteti infantil në Kosovë për vitin 2018 është 10.6 %. Sipas komunave, më i larti është në komunën e Shtimes me 25.9% dhe Kamenicë me 20.0%. (Tab.13)

**Tab. 8. Vdekshmëria e foshnjeve sipas moshës**

Foshnje të vdekura	Deri në 24 orë	1 – 6 ditë	7 – 27 ditë	1 – 11 muaj	Gjithsej
N	21	126	50	45	242
%	8.7	52.1	20.7	18.6	100.0

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2018



**Graf.6. Vdekshmëria e foshnjeve sipas moshës**

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2018

Nga gjithsej 242 foshnje të vdekura, 134 (55.4%) janë meshkuj dhe 108 (44.63%) femra (Tab.9). Prej 242 foshnjeve të vdekura, sipas moshës dhe gjinisë nuk ka dallim sinjifikant (hi katror testi 0.167, Shl=2, p=0.920). Poashtu edhe sipas moshës së nënës dhe rradhës së lindjes së fëmijës, nuk ka dallim sinjifikant (Tab. 9).

Vdekshmëria e foshnjeve sipas moshës dhe statusit martesor nuk ka dallim sinjifikant. Sa i përket nivelit të edukimit 112 (46.3%) nga 242 foshnje të vdekura janë të nënave me shkollë të mesme dhe 76 (31.4 %) të nënave me shkollë fillore të kryer (Tab.10).

**Tab.9. Vdekshmëria e foshnjeve sipas moshës, gjinisë, moshës së nënës dhe rradhës së lindjes së fëmijt**


#	Modalitete	Gjithsej		Moshë e foshnjeve të vdekura		
				Neonata e hershme	Neonatale	Post neonatale
		N	%	N	%	N
1	Gjinia	Meshkuj	134	80	28	26
		Femra	108	67	22	19
		<b>X<sup>2</sup>=0.167. ShL=2. p=0.920</b>				
2	Moshë e nënës	15 – 24	42	27	8	7
		25 – 34	141	80	34	27
		35+	59	40	8	11
		<b>X<sup>2</sup>=3.356. ShL=4. p=0.500</b>				
3	Radha e lindjes së fëmijës	Fëmija i parë	104	63	25	16
		I dyti	73	42	14	17
		I treti	43	31	5	7
		I katërti	22	11	6	5
		<b>X<sup>2</sup>=6.037. ShL=6. p=0.419</b>				

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2018

**Tab.10. Vdekshmëria e foshnjeve sipas statusit martesor dhe nivelit të edukimit të nënës**

#	Statusi martesor dhe niveli i edukimit të nënës	Moshë e foshnjeve të vdekura									
		Gjithsej		Neonatale e hershme		Neonatale		Postneonatale			
		N	%	N	%	N	%	N	%		
1	Statusi martesor i nënës	Gjithsej		242	100.0	147	100.0	50	100.0	45	100.0
				100.0	-	60.7	-	20.7	-	18.6	-
		E pamartuar	3	1.2	0	0.0	1	2.0	2	4.4	
		E martuar	237	97.9	147	100.0	48	96.0	42	93.3	
		E shkurorëzuar	2	0.8	0	0.0	1	2.0	1	2.2	
2	Niveli i edukimit të nënës	Pa shkollë	14	5.8	8	5.4	3	6.0	3	6.7	
		Shkollë fillore e pa kryer	3	1.2	3	2.0	0	0.0	0	0.0	
		Shkollë fillore e kryer	76	31.4	43	29.3	19	39.0	14	31.1	
		Shkollë e mesme	112	46.3	65	44.2	22	44.0	25	55.6	
		Shkollë e lartë	13	5.4	9	6.1	2	4.0	2	4.4	
		Fakultet	22	9.1	17	11.6	4	8.0	1	2.2	
E pa njohur	2	0.8	2	1.4	0	0.0	0	0.0			

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2018



**Graf.7. Vdekshmëria e foshnjeve sipas grup-moshës**

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2018

## VDEKSHMËRIA FETALE


Sipas IKSHPK, departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISH), numri i foshnjeve të lindura vdekur për vitin 2018 ka qenë 137 ose vdekshmëri fetale 4.8%. Sipas niveleve të Kujdesit Shëndetësor 96 (70.1%) kanë ndodhë në QKUK, 39 (28.5%) në spitale. (Tab.11).

**Tab.11. Foshnjët e lindura pa jetë sipas institucioneve shëndetësore, 2018**

#	Institucioni	Prej tyre të lindura pa jetë	
		N	%
1	QKUK	96	70.1
2	Spitalet e përgjithshme	39	28.5
3	Maternitetet jashtëspitalore	1	0.7
4	<b>Institucionet publike</b>	<b>136</b>	<b>99.3</b>
5	Institucionet private	1	0.7
6	<b>Gjithsej</b>	<b>137</b>	<b>100.0</b>

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2018


Sipas IKSHPK-së, në nivelin terciar në QKUK, në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike, vdekshmëria fetale është më e larta 9.4%. Sa i përket spitaleve të përgjithshme, spitali i Gjilanit ka shkallën më të lartë të vdekshmërisë fetale (6.4%), pasuar nga spitali i Prizrenit me 4.7%. Spitali i Ferizajit dhe Vushtrisë nuk kanë raportuar asnjë rast të vdekjeve fetale. Maternitetet e KPSH-së kanë raportuar 1 vdekje fetale, poashtu edhe në institucionet private është regjistruar 1 vdekje fetale. (Graf.8).



**Graf. 8 Vdekshmëria fetale sipas institucioneve shëndetësore publike**

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2018

Vdekshmëria fetale ka trend të rënies me lëvizje variabile. Në vitin 2000 shkalla e vdekshmërisë fetale ishte 14.5% ndërsa në vitin 2018 është 4.8% (Graf.9).



**Graf. 9 Shkalla e vdekshmërisë fetale, 2000-2018**

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2018

## VDEKSHMËRIA PERINATALE

Vdekshmëria perinatale pasqyron vdekshmërinë fetale dhe vdekshmërinë e hershme neonatale së bashku për një periudhë të caktuar kohore në një territor të caktuar, për krahasim ndërkombëtar.

Në vitin 2018 në Kosovë, shkalla e vdekshmërisë perinatale ishte 11.2%.

Sipas gjinisë mortaliteti perinatal tek meshkujt është 11.4% ndërsa tek femrat 11.0% (Tab.12)

Sipas të dhënave në dispozicion nga ASK, mortaliteti perinatal për periudhën 2011-2018 me vlerën mesatare në vit prej 10.9%, tregon tendencë shumë të lehtë të rënies mesatare me 0.1% ,mirëpo me lëvizje variabile (Graf.10).

Dallojnë vlerat e mortalitetit perinatal gjatë viteve 2011-2018 me raportet perinatale të mëhershme 2000-2015 të prezantuara në tabelën 1 varësisht prej burimit të të dhënave mirëpo bashkëpunimi i intensifikuar mes ASK, MSH dhe IKSHPK ka rezultuar me përfrim të të dhënave të raportuara krahasuar me vitet paraprake.

Sipas komunave shkalla më e lartë dhe shqetësuese është në komunën e Shtimes me 22.9%

Deçan 16.8 % dhe Fushë Kosovë 16.5%, ndërsa shkalla më e ultë është në komunën e Rahovecit me 4.7% (Tab.13).

**Tab.12. Mortaliteti i përgjithshëm 2018 i ndarë sipas gjinisë**

Mortaliteti perinatal në vitin 2018		
Mortaliteti i përgjithshëm	Mortaliteti sipas gjinisë (%)	
	M	F
11.2 %	11.4 %	11.0 %



**Graf. 10. Trendi i mortalitetit perinatal, 2000-2018**

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2018

### **Vdekshmëria e hershme neonatale (0 – 6 ditë)**

Shkalla e vdekshmërisë së hershme neonatale (0 – 6 ditë) për vitin 2018 është 6.5%. Sipas komunave gjegjësisht vendbanimit të foshnjeve, shkalla më e lartë e vdekshmërisë së hershme neonatale është në komunën e Shtimes 20.1 %, Deçanit 14.0%, Fushë Kosovës 12.8 % dhe Prishtinë 11.1% (Tab.14).

### **Vdekshmëria neonatale e vonshme (7 – 27 ditë)**

Shkalla e vdekshmërisë së vonshme neonatale (7 – 27 ditë) për vitin 2018 është 2.2%. Sipas komunave, shkalla më e lartë e vdekshmërisë së vonshme neonatale është në komunën e Kamenicës 12.0%, Malishevë 6.3%, dhe Gillogovc 5.1% (Tab.14).

### **Vdekshmëria neonatale (0-28 ditë)**

Shkalla e vdekshmërisë neonatale (0-28 ditë) për vitin 2018 është 8.9%. Sipas komunave, shkalla më e lartë e vdekshmërisë neonatale është në komunën Shtimes 23.0%, Deça 19.7% dhe Kamenicë 16.0%. (Tab.14).

### **Vdekshmëria postneonatale (28-364 ditë)**

Vdekshmëria postneonatale për vitin 2018 është 1.8%. Shkalla më e lartë e vdekshmërisë postneonatale ishte në komunën e Mamushës me 14.5%, Kamenicës me 4.0% dhe Malishevë me 3.8% (Tab.14).

Tab. 13. Shkalla e vdekshmërisë perinatale dhe infantile sipas komunave, 2018

Komunat	Mortaliteti Infantil	Mortaliteti Perinatal
Deçan	19.7	16.8
Gjakovë	8.5	6.6
Glllogovc	15.2	8.9
Gjilan	12.7	11.7
Dragash	6.7	13.2
Istog	0.0	4.8
Kaçanik	11.0	10.9
Klinë	6.2	10.3
Fushë Kosovë	17.9	16.5
Kamenicë	20.0	11.9
Mitrovicë	8.3	11.1
Leposaviq	0.0	0.0
Lipjan	3.7	8.6
Novobërdë	0.0	0.0
Obiliq	3.0	0.0
Rahovec	4.7	4.7
Pejë	8.1	9.9
Podujevë	12.1	11.1
Prishtinë	16.6	15.9
Prizren	9.7	11.4
Skenderaj	9.1	9.1
Shtime	25.9	22.9
Shtërpcë	0.0	0.0
Suharekë	8.5	9.9
Ferizaj	6.6	9.8
Viti	11.2	9.3
Vushtrri	5.0	10.9
Zubin Potok	0.0	0.0
Zveçan	0.0	0.0
Malishevë	17.5	14.9
Junik	0.0	0.0
Mamushë	14.5	14.3
Hani i Elezit	0.0	0.0
Graçanicë	0.0	0.0
Ranillug	0.0	0.0
Partesh	0.0	0.0
Klllokot	0.0	0.0
Mitrovicë e Veriut	0.0	0.0
Jashtë Kosovës	12.3	47.6
Gjithsej	10.6	11.2

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2018

Tab. 14 Shkalla e vdekshmërisë infantile sipas komunave dhe moshës, 2018

Komunat	Mortaliteti neonatal			
	hershëm	vonshëm	Neonatal	Post-neonatal
Deçan	14.0	2.8	19.7	0.0
Gjakovë	5.7	1.9	7.6	0.9
Gillogovc	7.6	5.1	12.7	2.5
Gjilan	6.3	3.6	10.0	2.7
Dragash	6.7	0.0	6.7	0.0
Istog	0.0	0.0	0.0	0.0
Kaçanik	6.6	2.2	8.8	2.2
Klinë	4.2	2.1	6.2	0.0
Fushë Kosovë	12.8	2.6	15.3	2.6
Kamenicë	4.0	12.0	16.0	4.0
Mitrovicë	5.6	1.9	7.4	0.9
Leposaviq	0.0	0.0	0.0	0.0
Lipjan	3.7	0.0	3.7	0.0
Novobërdë	0.0	0.0	0.0	0.0
Obiliq	0.0	0.0	0.0	3.0
Rahovec	3.1	1.6	4.7	0.0
Pejë	4.5	0.9	5.4	2.7
Podujevë	5.6	2.8	9.3	2.8
Prishtinë	11.1	2.8	14.5	2.2
Prizren	6.0	1.4	7.4	2.3
Skenderaj	6.1	1.5	7.6	1.5
Shtime	20.1	2.9	23.0	2.9
Shtërpcë	0.0	0.0	0.0	0.0
Suharekë	5.7	1.4	7.1	1.4
Ferizaj	3.3	2.6	5.9	0.7
Viti	7.4	1.9	9.3	1.9
Vushtrri	3.0	0.0	4.0	1.0
Zubin Potok	0.0	0.0	0.0	0.0
Zveçan	0.0	0.0	0.0	0.0
Malishevë	7.5	6.3	13.8	3.8
Junik	0.0	0.0	0.0	0.0
Mamushë	0.0	0.0	0.0	14.5
Hani i Elezit	0.0	0.0	0.0	0.0
Graçanicë	0.0	0.0	0.0	0.0
Ranillug	0.0	0.0	0.0	0.0
Partesh	0.0	0.0	0.0	0.0
Kllokot	0.0	0.0	0.0	0.0
Mitrovicë e Veriut	0.0	0.0	0.0	0.0
Jashtë Kosovës	12.3	0.0	12.3	0.0
Gjithsej	6.5	2.2	8.9	1.8

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2018

## PËRFUNDIMET

- Në vitin 2018, sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, janë raportuar gjithsej 22,870 lindje, 6,210 janë lindje jashtë Kosovës.
- Prej gjithsej lindjeve në Kosovë, 22,761 janë të lindur gjallë dhe 109 të lindur vdekur.
- Sipas gjinisë së të porsalindurve, 11,874 (52.2%) janë të gjinisë mashkullore me raportin gjinor në lindje 1,091 meshkuj në çdo 1,000 femra të lindura gjallë.
- Shkalla e lindjeve me prerje Cezariane është 18.2%.
- Sipas nivelit të kujdesit shëndetësor, përqindja më e lartë e lindjeve është realizuar në spitale rajonale me 12,305 apo 53.1%, pason klinika obsterike gjinekologjike e QKU K-së me 9,963 lindje apo 43.0%, në maternitete 405 lindje apo vetëm 1.7%, ndërsa në spitalet private, spitali Bahceci, spitalin Amerikan, spitali Lindja dhe spitali Sirona 489 raste ose 2.1%.
- Sipas komunave më së shumti të lindur gjallë ka pasë në komunën e Prishtinës me 3,471 (11.9%) dhe komuna e Prizrenit me 2,972 (10.2%)
- Gjatë periudhës kohore 2000-2018 mesatarisht në vit kanë qenë 28,942 lindje me rënie mesatare prej 758 lindjeve në vit. Lindshmëria për periudhën 2000-2017 ka trend të rënies me lëvizje variable.
- Numri mesatar i lindjeve në ditë në institucionet shëndetësore spitalore më i larti është në klinikën Gjinekologjike Obsterike të QKUK-së me 27 lindje, pason Prizreni me 9.3 lindje, dhe më së paku në Vushtrri me 1 lindje në ditë.
- Me grup-peshë < 2500g janë 1,126 apo 4.9% të foshnjeve të porsalindura.
- Moshë mesatare e nënave ka qenë moshë 29 vjeçe.
- Lindjet me prerje cezariane krahasuar me vitin 2015 kanë rënie prej 27.3% në 18.2%.
- Në institucionet publike nga gjithsej 22,673 lindje, 3,830 (16.9%) janë me prerje cezariane ndërsa në institucionet private nga gjithsej 489 lindje, 383 (78.3%) janë me prerje cezariane. Sipas spitaleve, përqindja më e lartë e lindjeve me prerje cezariane është realizuar në spitalin e Pejës 699 (36.8%).
- Prej gjithsej 242 foshnjeve të vdekura, 147 (60.7%) janë vdekje neonatale të hershme, vdekjet neonatale 197 (81.4%), vdekje neonatale të vonshme 50 (20.7%) dhe 45 (18.6%) janë vdekje postneonatale ndërsa shkalla e vdekshmërisë sipas moshës është mortaliteti neonatal i hershëm 6.5%, mortaliteti neonatal i vonshëm 2.2% dhe mortaliteti postneonatal 1.8%.
- Mortaliteti infantil në Kosovë për vitin 2018 është 10.6 %. Sipas komunave, më i larti është në komunën e Shtimes me 25.9% dhe Kamenicë me 20.0%.
- Nga gjithsej 242 foshnje të vdekura, 134 (55.4%) janë meshkuj dhe 108 (44.63%) femra. Sipas moshës dhe gjinisë, sipas moshës së nënës, rradhës së lindjes së fëmijës, dhe statusit martesor nuk ka dallim sinjifikant.

- numri i foshnjeve të lindura vdekur për vitin 2018 ka qenë 137 ose vdekshmëri fetale 4.8%. Sipas niveleve të Kujdesit Shëndetësor 96 (70.1%) kanë ndodhë në QKUK, 39 (28.5%) në spitale.
- Vdekshmëria fetale për vitin 2018 është 4.8%, sipas institucioneve në QKUK është më e larta 9.4%. Sa i përket spitaleve të përgjithshme, spitali i Gjilanit ka shkallën më të lartë të vdekshmërisë fetale (6.4%), pasuar nga spitali i Prizrenit me 4.7% Spitali i Ferizajit dhe Vushtrrisë nuk kanë raportuar asnjë rast të vdekjeve fetale. Maternitetet e KPSH-së kanë raportuar 1 vdekje fetale, poashtu edhe në institucionet private është regjistruar 1 vdekje fetale
- Në vitin 2018 në Kosovë, shkalla e vdekshmërisë perinatale ishte 11.2%.
- Sipas të dhënave në dispozicion nga ASK, mortaliteti perinatal për periudhën 2011-2018 me vlerën mesatare në vit prej 10.9%, tregon tendencë shumë të lehtë të rënies mesatare me 0.1%, mirëpo me lëvizje variable
- Sipas komunave shkalla më e lartë është në komunën e Shtimes me 22.9%, Deçan 16.8 % dhe Fushë Kosovë 16.5%.

## REKOMANDIMET

- Në raportim të të dhënave perinatale të përfshihen të gjitha institucionet, publike dhe private si dhe të gjitha komunat.
- Të harmonizohet pyetësi për mbledhjen e të dhënave mes institucioneve relevante.
- Të organizohen trajnime të punëtorëve shëndetësorë për kodifikimin e shkaqeve të vdekjeve.
- Të përmirësohet niveli i raportimit të të dhënave për vdekjet maternale dhe shkaqet e vdekjeve të foshnjeve. Të hartohet fletparaqitja e vecantë për raportimin e vdekjes maternale nga të gjitha institucionet shëndetësore.
- Të fuqizohet qasja multidisiplinare në përmirësimin e kujdesit prenatal, kujdesit natal përmes organizimit të aktiviteteve sipas pakos së OBSH-së “Every Newborn action plan to end preventable deaths” (MSh, IKSHPK, KPSH, KDSH, KTSH) pasi që komponenta e hershme neonatale e mortalitetit perinatal mund të reagojë relativisht shpejt në ndërhyrjet programatike si Pakoja e OBSH-së për Kujdesin esencial për të porsalindurit.
- Të hartohen udhërrëfyesit dhe protokolet klinike dhe të monitorohet zbatimi i tyre në praktikë.
- Të realizohet vlerësimi i cilësisë së institucioneve shëndetësore që ofrojnë kujdes shëndetësor për nëna dhe fëmijë.
- Të planifikohet konform të gjeturave nga vlerësimi i performancës së institucioneve shëndetësore që ofrojnë kujdes shëndetësor për nëna dhe fëmijë.
- Të fuqizohet më tutje edukimi i vazhdueshëm profesional i punëtorëve shëndetësor.
- Të përmirësohet infrastruktura, pajisjet dhe furnizimi me barna në institucione që ofrojnë kujdes shëndetësor për nëna dhe foshnje.
- Të punohet në ngritjen e nivelit të njohurive për shëndetin e nënës dhe fëmijës përmes programeve dhe aktiviteteve të promovimit dhe edukimit shëndetësor në Kosovë.

## **BIBLIOGRAFIA**

1. IKSHPK, Lindjet 2018
2. ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2018
3. ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2018
4. Raporti Perinal European, 2015

# ANEKS

## Të dhënat për lindjet dhe vdekjet e foshnjeve sipas komunave, 2018-Kosovë

Komunat	Lindje	Lind. gjallë	Lgj		Të lindur vdekur	Vdekje							
			Femra	Meshkuj		Deri ne 24	1-6 ditë	7-27 ditë	28-30 ditë	1-3 muaj	4-7 muaj	8-11 muaj	< 1 vit
Deçan	357	356	173	183	1	1	4	1	1	0	0	0	7
Gjakovë	1060	1059	501	558	1	2	4	2	0	1	0	0	9
Gillogovc	789	788	372	416	1	1	5	4	0	1	1	0	12
Gjilan	1109	1103	556	547	6	0	7	4	0	3	0	0	14
Dragash	302	300	155	145	2	0	2	0	0	0	0	0	2
Istog	417	415	214	201	2	0	0	0	0	0	0	0	0
Kaçanik	458	456	214	242	2	1	2	1	0	1	0	0	5
Klinë	484	481	237	244	3	0	2	1	0	0	0	0	3
Fushë Kosovë	787	784	373	411	3	3	7	2	0	1	1	0	14
Kamenicë	252	250	113	137	2	0	1	3	0	1	0	0	5
Mitrovicë	1084	1078	518	560	6	0	6	2	0	1	0	0	9
Leposaviq	44	44	18	26	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Lipjan	810	806	376	430	4	0	3	0	0	0	0	0	3
Novobërdë	73	73	30	43	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Obiliq	335	335	163	172	0	0	0	0	0	1	0	0	1
Rahovec	645	644	315	329	1	0	2	1	0	0	0	0	3
Pejë	1116	1110	555	555	6	1	4	1	0	2	0	1	9
Podujevë	1077	1071	493	578	6	4	2	3	1	2	1	0	13
Prishtinë	3262	3246	1524	1722	16	3	33	9	2	4	3	0	54
Prizren	2186	2174	1035	1139	12	2	11	3	0	3	2	0	21
Skenderaj	661	659	329	330	2	1	3	1	0	1	0	0	6
Shtime	349	348	164	184	1	0	7	1	0	1	0	0	9
Shtërpcë	65	65	30	35	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Suharekë	705	702	320	382	3	0	4	1	0	1	0	0	6
Ferizaj	1532	1522	752	770	10	1	4	4	0	0	0	1	10
Viti	538	537	275	262	1	0	4	1	0	0	1	0	6
Vushtrri	1007	999	453	546	8	0	3	0	1	0	1	0	5
Zubin Potok	54	54	21	33	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Zveçan	35	35	18	17	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Malishevë	804	798	364	434	6	1	5	5	0	3	0	0	14
Junik	25	25	12	13	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mamushë	70	69	30	39	1	0	0	0	0	0	1	0	1
Hani i Elezit	115	115	57	58	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Graçanicë	29	29	14	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Ranillug	23	23	15	8	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Partesh	20	20	11	9	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Klllokot	29	29	15	14	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mitrovicë e Veriut	78	78	36	42	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Jashtë Kosovës	84	81	36	45	3	0	1	0	0	0	0	0	1
Gjithsej	22870	22761	10887	11874	109	21	126	50	5	27	11	2	242